

L I G J
Nr.8387, datë 30.7.1998

PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 7952, DATE 21.06.1995 "PER SISTEMIN
ARSIMOR PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore
kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar" në të gjitha nenet
fjalët "Ministria e Arsimit" ndryshohen dhe bëhen "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës".

Neni 2

Në nenin 13 shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:
"Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përcakton kriteret për dhënien e Medaljes së Artë
nxënësve që përfundojnë arsimin e mesëm publik apo privat me rezultate të shkëlqyera. "

Neni 3

Në nenin 25 shtohet paragrafi 25.3 me këtë përmbajtje:
"Institucioni arsimor, ku duhet të regjistrohet fëmija përcaktohet nga organet e pushtetit
lokal, me propozim të drejtorisë arsimore të rrethit"

Neni 4

Në nenin 43 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
"Ndër institucionet arsimore, publike, parauniversitare mund të privatizohen vetëm
institucionet e arsimit profesional. Në këto raste mjediset, pajisjet dhe trualli i tyre
privatizohen në përputhje me dispozitat në fuqi.
Ndalohet ndryshimi i destinacionit të institucionit arsimor publik të arsimit profesional të
privatizuar.

Neni 5

Në nenin 44, në pikën 44,1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Ministria e Arsimit dhe e Shkencës propozon institucionin arsimor publik të arsimit
profesional, i cili do të privatizohet. Miratimi bëhet nga Këshilli i Ministrave me vendim

të veçantë. Mënyrat dhe fazat e procesit të privatizimit përcaktohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Neni 6

Në nenin 44, në pikën 44.4, fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

"Leja për hapjen e institucioneve arsimore private nuk mund të jepet më parë se 3 muaj dhe jo më vonë se 1 vit nga koha e depozitimit të kërkesës. "

Neni 7

Pas nenit 44 shtohet neni 44/a, me këtë përmbajtje:

"44/a. 1. Krahas institucioneve arsimore private të niveleve të arsimit parauniversitar, lejohen hapja dhe funksionimi i institucioneve arsimore, private, plotësuese. Quhen të tilla ato institucione arsimore e njësi shkollimi që funksionojnë jashtë strukturave të institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet në drejtim të arsimit të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta, brenda ose jashtë planeve mësimore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

44/a.2. Leja për funksionimin e institucioneve arsimore, private, plotësuese jepet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës jo më parë se dy muaj nga data e depozitimit të kërkesës.

44.a.3. Kriteret për hapjen dhe funksionimin e tyre përcaktohen me akte nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. "

Neni 8

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"Kur nxënësit e moshës 6 deri 16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 1 000 deri në 10 000 lekë, si vijon:

59.1. Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30 - 50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 1 000 deri 3 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba bëhet 5 000 lekë.

59.2. Kur nxënësi mungon pa arsye mbi 50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 5 000 deri në 7 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti ose braktisjeje të shkollës, gjoba bëhet 10 000 lekë.

59.3. Vendimi i gjobës jepet nga kryetari i bashkisë apo i komunës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës.

Kundër vendimit të gjositjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja.

59.4. Përrjashtohen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë, shqiptare a të huaj, brenda vendit, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës në vendbanimin e tyre.

59.5. Përrjashtohen nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një, shkollë jashtë vendit."

Neni 9

Paragrafi i parë i nenit 61 ndryshohet si vijon:

"Hapja e institucioneve arsimore private dhe e institucioneve arsimore private plotësuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit në çdo rast, dënohen me gjobë, përkatësisht 500 000 lekë dhe 200 000 lekë, si dhe me ndërprerje të veprimtarisë së filluar."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2178, datë 3.8.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Rexhep Meidani